



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Analizë e shkurtë:
Nr. 02/2018 - IKD

Ligji ndalon “fluturimin e supermenëve” me shumë pozita drejtuese dhe ndalon përfitimet e mëdha të zyrtarëve publikë nga shitesat

Prishtinë, maj 2018

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Ky raport nuk paraqet domosdoshmërisht qëndrimet e donatorit.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Maj 2018

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përkrahur nga:



British Embassy
Prishtina

Përmbajtja

I.	Përmbledhje ekzekutive	4
II.	Kosova plotëson kriteret e BE-së në Ligjin e Konfliktit të Interesit	6
III.	Ligji ndalon praktikën e “supermenëve” me shumë pozita drejtuese	8
a.	Kryeprokurori “supermen”, mban tri pozita drejtuese në kundërshtim me ligjin	8
1.	Pozitë e lartë drejtuese - Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit	8
2.	Pozitë e lartë drejtuese - Aleksandër Lumezi, Kryesues i Akademisë së Drejtësisë.....	9
3.	Pozitë e lartë drejtuese - Aleksandër Lumezi, Kryetar i Komisionit për Provim të Jurisprudencës .	9
b.	Vlerësimi i papajtueshmërisë e Kryeprokurorit të Shtetit, z. Aleksandër Lumezi.....	9
IV.	Ligji ndalon përfitimet e mëdha të zyrtarëve publikë përmes shtesave	11
V.	Rekomandime	12

I. Përmbledhje ekzekutive

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka analizuar procesin e hartimit dhe miratimit të Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike, për të cilin ka hartuar edhe një hulumtim parlamentar për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Miratimi i këtij ligji, avancoi rregullimin e fushës së parandalimit dhe luftimit të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike nga zyrtarët publikë, të cilët duke ushtruar funksionet e tyre në shumë pozita, kanë qenë përfitues të mëdhenj nga buxheti i shtetit.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik përfundimisht ka adresuar çështjen e “supermenëve” në institucionet publike, të cilët në të njëjtën kohë mbajnë disa pozita drejtuese. Praktika e “supermenëve” ndalohej në mënyrë eksplicite në nenin 13, paragrafin 2 të këtij ligji, i cili përcakton se “zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj.”

IKD vlerëson se shembulli i respektimit të zbatimit të sundimit të ligjit, respektivisht të zbatimit të këtij ligji duhet të vije nga institucionet më të larta të shtetit. Në këtë drejtim, institucioni më i thirrur për ndërtimin e këtij shembulli është Prokurori i Shtetit. Tash për tash, kreu i këtij institucioni, Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, është një prej “supermenëve” në institucionet publike, për shkak se ushtron tri pozita drejtuese në institucionet publike. Në të njëjtën kohë është Kryeprokuror i Shtetit, Kryetar i Këshilli Drejtues të Akademisë së Drejtësisë dhe Kryetar i Komisionit për Dhënie të Provimit të Jurisprudencës. Këtu përjashtohen edhe pozitat tjera jodrejtuese, duke përfshirë pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit si anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe anëtarë i Bordit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, për të cilat gjithashtu kompensohet si anëtar.

Sipas nenit 13 (2) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, zyrtarit të lartë i ndalohej të jetë drejtues i më shumë se një organi drejtues të një institucioni publik ***përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj.*** Kryeprokurori i Shtetit në asnjërën prej dy pozitave të tjera drejtuese nuk përcaktohet me ligj se duhet të jetë drejtues i institucionit. Prandaj, ushtrimi i këtyre pozitave drejtuese konsumon veprën penale të konfliktit të interesit, gjë që do duhej të ndiqej pikërisht nga Prokurori i Shtetit.

Një prej problemeve më të mëdha, rrjedhimisht përfitimeve më të mëdha për zyrtarët publikë janë shtesat për punën që ata bëjnë brenda orarit të rregullt të punës.

Praktika e pagesës së shtesave për zyrtarët publikë është ndërprerë me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit gjatë Ushtrimit të Funksionit Publik. Praktika e shtesave ndalohej në

mënyrë eksplicite në nenin 13, paragrafin 2 të këtij ligji, i cili përcakton se “zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.”

Për ta elaboruar këtë situatë, IKD sjellë shembullin e shtesave në Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial. IKD monitoron sistematikisht sistemin e drejtësisë dhe gjetjet dëshmojnë se shumica e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, përveç pagës bazë që marrin si gjykatës apo prokuror të deleguar nga gjykata dhe prokuroria përkatëse sipas rregullave dhe procedurave ligjore, në bazë të rregullave të brendshme të miratuara nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, para hyrjes në fuqi të këtij ligji pranojnë kompensim shtesë për punën që e bëjnë si anëtarë të dy këshillave. Një praktikë e tillë, bie ndesh me frymën dhe qëllimin e ligjit për konfliktin e interesit.

Në këtë drejtim është e domosdoshme që Këshillat, institucionet e tjera publike dhe Agjencia Kundër Korrupsion të ndërmarrin masa urgjente për sqarimin e këtyre situatave dhe të ndërmarrin veprime urgjente në parandalimin e veprimeve që potencialisht mund të hyn në sferën penale.

Problematika e pagimit të shtesave për zyrtarët publikë tashmë është qartësuar përmes ligjit dhe Agjencia Kundër Korrupsion duhet të njoftojë institucionet për dispozitat e reja të këtij ligji dhe të kërkojë që zyrtarët publikë të zbatojnë ligjin sa i përket pagesës së shtesave.

II. Kosova plotëson kriteret e BE-së në Ligjin e Konfliktit të Interesit

Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2016 për Kosovën, kishte kërkuar që gjatë vitit 2017, Kosova duhet në veçanti të ndryshojë kuadrin ligjor mbi konfliktin e interesave, duke përshtatur atë me standardet evropiane.

Në nëntor të vitit 2016, Kosova dhe Bashkimi Evropian (BE) përmes dialogut të nivelit të lartë ishin pajtuar lidhur me prioritet kyçe të Agjendës për Reforma Evropiane (ARE), në realizimin e veprimeve prioritare nga ana e institucioneve në Kosovë, me qëllim të zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim në drejtim të avancimit të Kosovës në rrugën e saj evropiane. Kosova në kuadër të plotësimit të kriterëve të përcaktuara në ARE, në kuadër të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, kishte marr për obligim ndryshimin e ligjit për konfliktin e interesit dhe rregulloreve përkatëse, duke i sjellë ato në përputhshmëri me standardet evropiane dhe të përcaktimit të rrethanave të sakta kur zyrtarët publik mund të angazhohen në punë shtesë dhe të emërohen. Sipas kërkesës së ARE, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike do të duhej të ndryshohej në harmoni me rekomandimet e BE-së, si në vijim:

- a) *Të përcaktohen qartë kategoritë e zyrtarëve publik;*
- b) *Të theksohen qartë aktivitetet që zyrtarëve iu lejohet dhe iu ndalohet t'i kryejnë përderisa mbajnë postin;*
- c) *Të theksohen qartë aktivitetet që zyrtarët e kanë të ndaluar t'i ushtrojnë pas përfundimit të mandatit;*
- d) *Të theksohen qartë obligimet e zyrtarëve dhe eprorëve të tyre në situata të konfliktit të interesit; dhe*
- e) *Të theksohen qartë procedurat që duhet aplikohen pas paraqitjes së konfliktit të interesit.*

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka analizuar procesin e hartimit dhe miratimit të Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike, për të cilin ka hartuar edhe një hulumtim parlamentar për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ky i fundit, në pajtim me obligimet e marra sipas ARE kishte miratuar Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, i cili ligj, më 20 prill 2018, ishte dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Ky ligj është publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës më 27 prill 2018, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit, respektivisht më 12 maj 2018.

Qëllimi i këtij ligji është forcimi i integritetit të sektorit publik dhe garantimi i kryerjes së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit

publik nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave të zyrtarëve.

Ligji ka përcaktuar parimin se zyrtari publik duhet ta kryejë punën e tij me ndershmëri, ndërgjegje, paanshmëri, të ruajë autoritetin e zyrtarit dhe institucionit dhe me punën e tij të forcojë besimin e qytetarëve në institucione.

Neni 13 i këtij Ligji, papajtueshmëria me ushtrimin e funksionit publik përcakton edhe situatat kur zyrtarit publik i ndalohet të ushroj më shumë se një pozitë në organe apo institucione drejtuese. Paragrafi 2 i këtij neni përcakton se *“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.”*

IKD si rezultat i monitorimit sistematik të institucioneve të drejtësisë ka identifikuar numër të madh të rasteve kur individë të caktuar brenda institucioneve të drejtësisë, mund të jenë në konflikt interesi, respektivisht mund të bien në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, nëse të njëjtit apo Agjencia Kundër Korrupsion nuk ndërmerr hapa urgjent në identifikimin dhe parandalimin e situatave të konfliktit të interesit.

Prokurori i Shtetit si kategori kushtetuese ka kompetencë dhe përgjegjësi në hetimin dhe ndjekjen e kryesve të veprave penale, përfshirë hetimin dhe ndjekjen penale të zyrtarëve publik që potencialisht përmes veprimit apo mos veprimit të tyre mund të bien në kundërshtim me parimet dhe dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zbatimi efikas i këtij ligji nga ana e Prokurorit të Shtetit, kërkon që vet ky institucion dhe bartësit kryesor të këtij institucioni të veprojnë në harmoni dhe pajtim me frymën e ligjit, si dhe të shërbej si udhërrëfyes lidhur me përmbushjen e obligimeve që dalin nga ky ligj.

IKD gjatë hulumtimit dhe analizës ligjore, dhe ndikimit në praktikë, ka identifikuar dy fusha kryesore që mund të krijojnë rrethana dhe situata të konfliktit të interesit nëse institucionet respektive nuk ndërmarrin masa për të parandaluar dhe luftuar situatat e konfliktit të interesit.

III. Ligji ndalon praktikën e “supermenëve” me shumë pozita drejtuese

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik përfundimisht ka adresuar çështjen e “supermenëve” në institucionet publike, të cilët në të njëjtën kohë mbajnë disa pozita drejtuese. Praktika e “supermenëve” ndalohej në mënyrë eksplicite në nenin 13, paragrafin 2 të këtij ligji, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj.”

IKD vlerëson se shembulli i respektimit të zbatimit të sundimit të ligjit, respektivisht të zbatimit të këtij ligji duhet të vije nga institucionet më të larta të shtetit. Në këtë drejtim, institucioni më i thirrur për ndërtimin e këtij shembulli është Prokurori i Shtetit.

Tash për tash, kreu i këtij institucioni, Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, është një prej “supermenëve” në institucionet publike, për shkak se ushtron tri pozita drejtuese në institucionet publike. Këtu përjashtohen edhe pozitat tjera jodrejtuese, duke përfshirë pozitën e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe anëtarit të Bordit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, për të cilat gjithashtu kompensohet si anëtar.

a. Kryeprokurori “supermen”, mban tri pozita drejtuese në kundërshtim me ligjin

Kryeprokurorit të Shtetit z. Aleksandër Lumezi përveç ushtrimit të pozitës së lartë drejtuese të institucionit të Prokurorit të Shtetit, në të njëjtën kohë ushtron edhe dy funksione tjera të larta drejtuese, si pozitën e Kryesuesit të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë dhe Kryetarit të Komisionit për Provim të Jurisprudencës.

1. Pozitë e lartë drejtuese - Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit

- a) Aleksandër Lumezi, më 21 prill 2015, sipas propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, është emëruar Kryeprokuror i Shtetit nga ish-Presidentja e Republikës, Atifete Jahjaga. Sipas Ligjit të aplikueshëm për Prokurorin e Shtetit, Kryeprokurori i Shtetit është kreu i Prokurorit të Shtetit, me përgjegjësi për menaxhimin dhe përfaqësimin e Prokurorit të Shtetit dhe të strukturave të prokurorive, të cilat e përbëjnë Prokurori e Shtetit.
- b) Sipas Ligjit të aplikueshëm për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Kryeprokurori i Shtetit, sipas detyrës zyrtare është edhe anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

2. Pozitë e lartë drejtuese - Aleksandër Lumezi, Kryesues i Akademisë së Drejtësisë

Më 3 prill 2017, Këshilli Drejtues kishte zgjedhur Kryeprokurorin e Shtetit, Aleksandër Lumezi, Kryesues të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë. Sipas ligjit, Kryesuesi i Këshillit Drejtues përfaqëson Këshillin, thërret dhe udhëheq mbledhjet e Këshillit dhe kryen përgjegjësi të tjera të përcaktuara me ligj dhe me Rregulloren e punës, të cilën e nxjerr Këshilli Drejtues.

Sipas nenit 8 të Ligjit për Akademinë e Drejtësisë, Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, si organ drejtues i lartë udhëheq me Akademinë dhe përbëhet nga nëntë anëtarë, prej të cilëve Kryetari i Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurori i Shtetit janë anëtar sipas detyrës zyrtare. Sipas këtij Ligji, Këshilli Drejtues nga radhët e anëtarëve të tij zgjedh kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin me shumicë votash me mandat katër (4) vjeçar.

3. Pozitë e lartë drejtuese - Aleksandër Lumezi, Kryetar i Komisionit për Provim të Jurisprudencës

Më 15 prill 2018, sipas propozimit të Ministrisë së Drejtësisë të dërguar përmes Qeverisë, Kuvendi i Kosovës ka votuar komisionin për provimin e jurisprudencës, ku Kryetar i këtij Komisioni është emëruar Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit.

Sipas Ligjit për Provimin e Jurisprudencës, Komisioni për Dhënie të Provimit të Jurisprudencës, është organ i pavarur profesional, i cili organizon provime për kualifikimin e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve juristëve të diplomuar të tjerë për të cilët për ushtrimin e profesionit kërkohet të ketë dhënë provimin e jurisprudencës.

Komisioni për Provimin e Jurisprudencës përbëhet nga kryetari i komisionit, anëtarët e komisionit dhe zëvendësit e tyre. Kryetarin, anëtarët e komisionit dhe zëvendësit e tyre i propozon ministri i drejtësisë dhe i emëron Kuvendi i Kosovës, me mandat dy (2) vjet, me mundësi riemërimi. Komisioni emërohet nga radhët e juristëve të diplomuar, të cilët e kanë dhënë provimin e jurisprudencës, që janë ekspertë të drejtësisë dhe që kanë së paku dymbëdhjetë (12) vjet përvojë punë në sistemin e drejtësisë. Komisioni për punën e vet i raporton Kuvendit së paku një herë në vit.

b. Vlerësimi i papajtueshmërisë e Kryeprokurorit të Shtetit, z. Aleksandër Lumezi

Sipas nenit 13 (2) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, zyrtarit të lartë i ndalohej të jetë drejtues i më shumë se një organi drejtues të një institucioni publik ***përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj***. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblymi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.”

Përderisa, Ligji për Akademinë e Drejtësisë, përcakton shprehimisht se Kryeprokurori i Shtetit është anëtar i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, sipas ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, mbajtja e pozitës së Kryesuesit të Këshillit Drejtues, si pozitë e lartë drejtuese e vë Kryeprokurorin e Shtetit në kundërshtim me nenin 13(2) të këtij ligji.

Përderisa, Ligji për Provimin e Jurisprudencës nuk ka dispozitë ligjore që përcakton se Kryeprokurori i Shtetit duhet të jetë anëtar apo Kryetar i Komisionit për Provim të Jurisprudencës. Ligji këtë kompetencë ia ka deleguar Ministrin të Drejtësisë për të propozuar anëtarët dhe kryetarin e këtij Komisioni, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara me ligj, dhe miratimin e këtij propozimi nga Kuvendi i Kosovës.

Mbajtja e pozitës së Kryetarit të Komisionit për Provim të Jurisprudencës nga Kryeprokurori i Shtetit, vë të njëjtin në kundërshtim me nenin 13(2) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit gjatë Ushtrimit të Funkcionit Publik.

Në këtë drejtim, IKD ka elaboruar vetëm pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, e cila bie në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit gjatë Ushtrimit të Funkcionit Publik, me qëllimin e vetëm që respektimi i dispozitave të këtij ligji të jetë shembull nga institucioni më i thirrur për zbatimin e këtij ligji, shkelja e të cilit, duhet të ndiqet pikërisht nga institucioni i prokurorit të shtetit.

IKD vlerëson se Agjencia Kundër Korrupsionit ka në mandatin e saj, zbatimin e këtij ligji në parandalimin dhe luftimin e konfliktit të interesit, duke filluar prej pozitës së Drejtorit të Agjencisë, Kryeprokurorit të Shtetit e deri tek të gjitha pozitat e zyrtarëve publik të cilët bien në kundërshtim me këtë ligj. Agjencia me rastin e hyrjes së ligjit në fuqi është dashur të njoftojë institucionet për dispozitat e reja të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit gjatë Ushtrimit të Funkcionit Publik dhe të kërkojë që zyrtarët publikë të deklarojnë konfliktin e interesit dhe të njëjtën kohë të kërkojnë informacione nëse ka situata të tilla të cilat nuk janë deponuar në Agjenci.

Agjencia Kundër Korrupsionit duhet të veprojë me urgjencë në mënyrë që të shmangen pasojat e mëdha të cilat mund të prodhohen si rezultat i konfliktit të interesit.

IKD vlerëson se miratimi i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si kërkesë e Bashkimit Evropian dhe zotim i Republikës së Kosovës, në rrugën e saj evropiane përmes të plotësimit të kriterëve të përcaktuara në ARE, në kuadër të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, ka ndërtuar një standard të ri në përputhshmëri me standardet evropiane për parandalimin dhe luftimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve publikë, rrjedhimisht për ndalimin e përfitimeve të zyrtarëve publike në cilësinë e “supermenëve” duke

ushtruar disa pozita drejtuese dhe duke u kompensuar me shtesa brenda fushë veprimtarisë së tyre në orar të rregullt të punës.

IV. Ligji ndalon përftimet e mëdha të zyrtarëve publikë përmes shtesave

Një prej problemeve më të mëdha, rrjedhimisht përfitimeve më të mëdha për zyrtarët publikë janë shtesat për punën që ata bëjnë brenda orarit të rregullt të punës.

Praktika e pagesës së shtesave për zyrtarët publikë është ndërprerë me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit gjatë Ushtrimit të Funkcionit Publik. Praktika e shtesave ndalohet në mënyrë eksplicite në nenin 13, paragrafin 2 të këtij ligji, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.”

Për ta elaboruar këtë situatë, IKD sjellë shembullin e shtesave në Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial. IKD monitoron sistematikisht sistemin e drejtësisë dhe gjetjet dëshmojnë se shumica e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, përveç pagesë bazë që marrin si gjykatës apo prokuror të deleguar nga gjykata dhe prokuroria përkatëse sipas rregullave dhe procedurave ligjore, në bazë të rregullave të brendshme të miratuara nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, para hyrjes në fuqi të këtij ligji pranojnë kompensim shtesë për punën që e bëjnë si anëtarë të dy këshillave.

Një praktikë e tillë, bie ndesh me frymën dhe qëllimin e ligjit për konfliktin e interesit, i cili përcakton se *“zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve publike nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.”*

Në këtë drejtim është e domosdoshme që Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial dhe Agjencia Kundër Korrupsion të ndërmarrin masa urgjente për sqarimin e këtyre situatave dhe të ndërmarrin veprime urgjente në parandalimin e veprimeve që potencialisht mund të hyn në sferën penale.

Problematika e pagimit të shtesave për zyrtarët publikë tashmë është qartësuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit gjatë Ushtrimit të Funkcionit Publik dhe Agjencia Kundër Korrupsion duhet të njoftojë institucionet për dispozitat e reja të këtij ligji dhe të kërkojë që zyrtarët publikë të zbatojnë ligjin sa i përket pagesës së shtesave.

V. Rekomandime

1. Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Kundër Korrupsion të ndërmarrin veprime urgjente që përmes kampanjës vetëdijësuese të informojnë jo vetëm institucionet e drejtësisë por edhe të gjitha institucionet publike dhe zyrtarët publikë lidhur me ndikimin që do të ketë në praktikë ky ligj.
2. Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës të ndërmarrin veprime urgjente në parandalimin e situatave të konfliktit të interesit të zyrtarëve publikë në këto dy institucione.
3. Të gjitha institucionet publike të në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të tyre të ndërmarrin veprime për të parandaluar situatat e konfliktit potencial të interesit dhe të sigurohen që ky ligj të zbatohet në përpikëri.
4. Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës të shqyrtojnë ligjin në fjalë dhe të sigurohen në parandalimin e çfarëdo situatave të konfliktit të interesit për anëtarët e dy Këshillave dhe personelit tjetër.
5. Kryeprokurori i Shtetit të shqyrtoj pozitën e tij si Kryesues i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë dhe Kryetarit të Komisionit për Provim të Jurisprudencës, dhe të veprojë në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.
6. Agjencia Kundër Korrupsion në pajtim me mandatin e saj, të vlerësojë dhe parandalojë situatat e konfliktit të interesit të zyrtarëve publik pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.